

Kontratë Relatech Academy

Midis Z./Znj _____, lindur në _____ më _____
banues në _____, adresa _____, email: _____, tel _____
sipermarrja _____, nr NIPT _____
shkurtimisht i emërtuar si “kursant”

dhe

Relatech Albania sh.p.k., shkurtimisht i emërtuar si “organizator”, person juridik sipas legjislacionit shqiptar, regjistruar në QKB në datë 07/12/2016 me nr. NIPT: L62407014P adresa: Rruga Donika Kastrioti, Pallati nr 14, Kati 1, Apartamenti 7. tel: +355 45 601170, email academy@relatech.com , me administrator **Z. Tommaso Marseglia**

Bien dakord dhe nënshkruajnë sa më poshtë:

Organizatori do t’i ofrojë kursantit kompetenca të teknologjisë së informimit (IT) në sektorin e programimit duke mundësuar provimin e nevojshëm për certifikatat e njohura ndërkombëtarisht dhe për ta vënë në kushte për t’u punësuar me kualifikimin si Programues Junior në tregun evropian të punës dhe, me kalimin me sukses të provimit përfundimtar, do ta regjistrojë në sistemin e të dhënave të ofertave të punës ndërkombëtare HAYS.

Karakteristikat e kursit:

- Orari, kohëzgjatja: 5 ditë javore, nga ora 09.00 deri në orën 18.00 (me një orë pushimi në mesditë) për një shumë prej 1500 orësh (gati 9 muaj), duke filluar nga periudha shtator-tetor 2018, dhe përfundimi 9 muaj nga data e fillimit;
- Vendi: kursi do të zhvillohet në Tiranë, Shqipëri
- Lëndët: kursi do të përqëndrohet fillimisht mbi një periudhë bazë të detyrueshme prej 6-8 javësh, një periudhë të dytë prej 6 muajsh në laborator, të ndarë në grupe omogjene sipas përmbajtjes (të zgjedhura nga personeli mësimdhënës) dhe një periudhë të fundit 6 javore, po në laborator, me ushtrime praktike dhe raste konkrete të zhvillimit të aplikacioneve.
- Docentët: kursi do të mbahet nga docentë ndërkombëtarë
- Gjuha e mësimdhënies: i gjithë kursi do të zhvillohet në gjuhën angleze
- Gjuha e dytë: jashtë orarit të leksioneve, kursanti mund të ndjekë, me shpenzimet e organizatorit, një kurs perfeksionimi në një nga dy gjuhët (italisht dhe anglisht) me qëllim lehtësimin e stabilizimit të tij jashtë vendit

Materiali didaktik

Duke nisur nga fillimi i periudhës së dytë, kursantit do t'i dorëzohet:

- një *laptop windows* Dell Vostro, Processor: 7th Generation Intel®Core™ i5-7200U 2.5GHZ, Operating system: Windows 10 Professional (ose nje laptop tjetër me karakteristika të njejta ose me të avancuara)
- nje *smartphone android* Huawei P8 Lite, Network: GSM/HSPA/LTE, Cpu: Octa-core 1.2GHZ Cortex-A53, Size 5.0 Inches (ose nje smartphone android tjetër me karakteristika të njejta ose me të avancuara)
-

të cilët do të përbëjnë mjetet e veta didaktike dhe do të mbeten në pronësinë e tij. Gjithashtu, gjatë periudhës së leksioneve, kursanti mund të përdorë laboratorin didaktik të pajisur me *laptop* dhe *IOS mobile* për leksionet e lidhura me atë sistem operativ.

Provimi përfundimtar

Në përfundim të fazës së tretë, kursanti do të zhvillojë një provim të përgjithshëm për marrjen e dijeve dhe do të ketë akses provimet për certifikimet.

Certifikatat e lëshuara

Organizatori nuk lëshon titull me vlerë ligjore, që gjithësesi nuk do të ishte i njohur në tregun botëror të informatikës, por i jep mundësi kursantit të marrë pjesë në provimet për certifikimet ISTQB, .NET, SCRUM dhe ORACLE të njohura ndërkombëtarisht në tregun botëror, si dhe një certifikatë pjesëmarrje.

Përgjegjësitë e kursantit, frekuentimi

Kursi u drejtohet kursantëve seriozisht të interesuar për të përvetësuar teknikat dhe gjuhët e programimit aktualisht në përdorim në tregun botëror, prandaj mbetet në përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të kursantit të zgjedhë frekuentimin e leksioneve dhe të përfitojë nga mundësitë didaktike të vëna në dispozicion nga organizatori.

Regjistrimi në sistemet e të dhënave të tregut të punës

Në përfundimin me sukses të provimit final, kursanti do të regjistrohet në sistemin botëror të të dhënave HAYS me kualifikimin Programues *Junior* dhe CV e tij do t'i dërgohet të gjitha sipërmarrjeve partnere

Detyrimi i organizatorit përfundon me paraqitjen kursantit, i cili ka kaluar me sukses provimin përfundimtar, të të paktën një oferte punësimi në një nga këto vende (Shqipëri, Gjermani, Itali) me një pagë neto vjetore të paktën 9000 euro për Shqipërinë.

Organizatori nuk ka asnjë përgjegjësi në rast të mos-nënshkrimit të kontratës së punës, kur kjo vjen nga refuzimi i kursantit.

Tarifat e kursit

Për të marrë pjesë në kurs (përfshirë dhënien e laptop-it, telefonit celular dhe të kursit për gjuhën e dytë), kursanti duhet t'i paguajë organizatorit 666.667 Lek + TVSH, të barabartë me 800.000 Lek.

Mënyrat e pagesës

Pagesa e parë prej 240.000 Lek, e barabartë me 30% të shumës së përgjithshme, duhet të derdhet në llogarinë IBAN **AL60 2131 1116 0000 0000 0146 5146**, në emër të RELATECH ALBANIA, me objekt "Emër dhe Mbiemër të kursantit-kursi Maj 2018", brenda javës që paraprind fillimin e kursit; diferenca prej 560.000 Lek duhet të derdhet me të njëjtat modalitete, me kërkesën e organizatorit, brenda javës së gjashtë pas fillimit të kursit.

Lëshimi i faturës

Në momentin e mbërritjes së pagesës në llogarinë bankare, organizatori do t'i dorëzojë kursantit një faturë të rregullt TVSH-je ose, për subjektet që nuk preken nga regjimi i TVSH-së, një kupon tatimor me vlerë të njëjtë.

Mospagesa e këstit të dytë të taksës

Në rast të mospagesës së këstit të dytë të taksës brenda javës së gjashtë prej fillimit të kursit, shuhet çdo lloj detyrimi i organizatorit ndaj kursantit, materiali didaktik do të mbetet në pronësinë e organizatorit dhe kursantit nuk do t'i lejohet më të ndjekë leksionet apo të pretendojë pronësinë e materialit didaktik deri në derdhjen e plotë të detyrimit.

Huaja bankare, pagesa në një këst të vetëm

Nëse kursanti dëshiron të kërkojë një hua bankare, organizatori zotohet t'i përcjellë bankës së tij, me kërkesë të vetë kursantit, certifikatën e regjistrimit në kurs, një kopje të kësaj kontrate dhe, sipas rastit, një deklaratë mbi rezultatin e provimit të pranimit.

Në rast të pagesës në një këst të vetëm, organizatori do të zbatojë në favor të kursantit, një zbritje në faturë prej 2% nga kësti i dytë, të barabartë me 11.200 Lek.

Tërheqja nga kontrata

Kursanti mund të kërkojë anulimin e kontratës dhe kthimin e shumave të derdhura deri në dhjetë ditë përpara fillimit të kursit.

Shtyrje apo anulim i kursit

Në rast se organizatori vendos shtyrjen e fillimit të kursit për një periudhë më të madhe se tri javë nga data e parashikuar, apo vendos të anulojë kursin, kursanti ka të drejtën e rikthimit të shumës së derdhur.

Të drejtat e autorit

Përdorimi i liçencave software mbi materialin didaktik është i mbuluar nga organizatori gjatë gjithë kohëzgjatjes së kursit; rinovimi i këtyre liçencave në periudhat e mëvonshme do të jetë në ngarkim të kursantit.

Trajtimi i të dhënave personale

Kursanti autorizon në mënyrë të shprehur organizatorin të trajtojë të dhënat e tij personale dhe e autorizon t'ia përcjellë këto të dhëna të tretëve për të arritur qëllimet e kësaj kontrate.

Materiali didaktik

Materiali didaktik do t'i dorëzohet kursantit pas kolaudimit dhe pajisjes së tyre me *software-t* e nevojshëm për zhvillimin e aktiviteteve didaktike, ose nëpërmjet modalitetit të aksesit në distancë. Përdorimi i tyre jashtë ambienteve të kursit është plotësisht i lejuar, por me përgjegjësinë e plotë të kursantit. Vjedhja dhe/apo keqfunksionimi i shkatuar nga përdorimi jokorrekt, nga energjia elektrike apo nga virus i marrë për shkak të përdorimit të pakujdesshmëm, nuk janë në asnjë mënyrë përgjegjësi e organizatorit dhe dëmet apo ngadalësimet mbi aktivitetin didaktik të kursantit nuk mund t'i atribuohen në asnjë mënyrë organizatorit.

Materiali didaktik, pas dorëzimit kursantit, kalon në pronësinë e tij dhe organizatori në asnjë mënyrë nuk përgjigjet, përtej garancisë së zakonshme tregtare të ofruar nga prodhuesi, për dëme, thyerje, humbje të plotë apo të pjesshme, apo për keqfunksionim, të plotë apo të pjesshëm, të

shkatuar në çdo lloj mënyre. Në rast nevoje, organizatori mund të ofrojë, kundrejt pagesës, material didaktik zëvendësues.

Disiplina dhe sjella personale

Kursanti i njeh organizatorit të drejtën për ta përjashtuar dhe për mos ta pranuar në ambientet e kursit në rast të vërejtjeve formale të përsëritura disiplinore, mbi sjelljen personale dhe respektimin e sendeve të kursantëve të tjerë apo të organizatorit. Në rast të përjashtimit pas ankesave me shkrim të tre ose më shumë kursantëve, organizatori nuk ka asnjë detyrim ndaj kursantit.

Garanci e shprehur e përgjithshme e kontratës

Organizatori Relatech Albania sh.p.k., zotohet t'i kthejë kursantit të gjithë vlerën e këstit të dytë (të barabartë me 560.000 Lek) nëse, pas përfundimit me sukses të provimit final, kur ky i fundit, brenda tri muajve pasardhës nga përfundimi i kursit, nuk ka marrë asnjë oferte pune në Shqipëri për një pagë neto vjetore jo më të vogël se 9.000 euro.

Arsye të forcës madhore

Nëse kursi do të ndërpritet përpara afatit për arsye lufte, revolucioni, kryengritjesh apo krizash të tjera të rënda apo pengesash të shkaktuara nga njeriu apo nga qeveritë dhe që shkojnë përtej pushtetit dhe mundësive teknike të organizatorit, ky i fundit do t'i rimburojë kursantit një shumë në përpjestim me periudhën e pazhvilluar të kursit, pasi të ketë zbritur vlerën e materialit didaktik të dorëzuar kursantit.

Juridiksioni kompetent

Juridiksioni kompetent për çdo mosmarrëveshje lidhur me këtë kontratë, që nuk është zgjidhur paraprakisht nga një ndërmjetësues, do të jetë Gjykata e Tiranës.

Datë _____

Kursanti

Relatech Albania Sh.p.k.

Administrator

Kursanti deklaron shprehimisht:

- me përgjegjësi e tij te plotë se ka njohuri te mjaftueshme gjuhësore për të ndjekur kursin në gjuhën anglisht;
- se është i vetëdijshëm që po blen të drejtën për të frekuentuar një kurs për të mësuar kompetenca të një niveli te caktuar, dhe jo një titull studimi të njohur nga autoriteti shtetëror dhe të një vlere ligjore në Shqipëri apo në shtete të tjera;
- se është i vetëdijshëm se nuk po blen viza apo leje qëndrimi të asnjë vendi;
- se është i vetëdijshëm që po blen ekskluzivisht aksesin për kompetencat e nevojshme për të kandiduar në një vend pune, arritja efektive e të cilit mbetet e kushtëzuar nga niveli i tij i të mësuarit dhe nga gjykimi i padiskutueshëm i punëdhënësve të mundshëm të ardhshëm.

Kursanti
